



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.4/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas Kërkesa për inicim të procedurës disiplinore parashtuar nga ana e përfaqësuesit ligjor të dëmtuarës O.R., babait të saj K.R., nga Suhareka ndaj Gjyqtarit Gj.G., Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren dhe gjyqtar në degën në Gjykatë në Suharekë, Divizioni i Kundërvajtjes, lidhur me veprimet dhe sjelljen e Gjyqtarit të lartcekur, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.01.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit ligjor të dëmtuarës O.R., babait të saj K.R., nga Suhareka ndaj gjyqtarit Gj.G., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren dhe gjyqtar në degën në Gjykatë në Suharekë, Divizioni i Kundërvajtjes.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës O.R., babai i saj K.R., nga Suhareka ka cekur se me datë 26.05.2021 në Suharekë, në vendkalimin për këmbësor , në rreth rrotullim është shkelur vajza e tij O.R., nga ana e F.L-M., e cila ka hyrë në rreth rrotullim nga ana e kundërt dhe ka ikur nga vendi i ngjarjes. Më tej ka cekur se vajza e tij ka shenjë në kraharor si pasojë e lëndimit si dhe ka pasur problem me qafç, kurriz dhe problem me gjumin. Nga ana e gjykatës me datë 25.12.2022 ka pranuar vendimin KNR.264/2021-02 me të cilën F.L-M., është dënuar me 150€ gjobë për këtë aksident. Sipas tij ky dënim nuk është adekuat, është qesharak, nuk është ftuar në gjykim si dhe kjo është vepër penale dhe jo kundërvajtje dhe se duhet të cilësohet si vepër penale dhe të dënohet më rëndë, duhet të suspendohet patentë shoferi i ngasësit si dënim plotësues si dhe të gjykohet në Departament të përgjithshëm dhe jo në Divizion të Kundërvajtjes. Ndaj këtij vendimi kanë parashtuar ankesë të cilën gjyqtari e ka refuzuar dhe bazuar në të lartcekurat konsideron se gjyqtari në fjalë ose ka interes financiar ose e ka të familjes pasi që ka vendosur në këtë mënyrë.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka iniciuar hetimet për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtuar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes GJ.G., si dhe ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës dhe pasi ka analizuar pretendimet ankimore, ka konstatuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka pasur bazë për shkelje disiplinore pasi që pretendimet e përfaqësuesit ligjor të dëmtuarës O.R., babait të saj K.R., nga Suhareka nuk qëndrojnë për faktin se gjyqtari ka vendosur në kuadër të autorizimeve të tij dhe në bazë të ligjit.

Sa i përket faktit se dënimi i shqiptuar me giobë është i ulët dhe nuk paraqet vepër të kundërvajtjes por kemi të bëjmë me vepër penale me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.06/ L- 074, me datë 14.04.2019 i cili në kuptim të nenit 433 të KPK-së e ka shfuqizuar Kodin Penal nr.04/L-082, të ndryshuar dhe të plotësuar me ligjin 04/ L-129 që ka të bëjë me veprën penale rrezikimi i trafikut publik sipas nenit 378 par.6 që parashohin lëndimin e lehtë trupor të shkaktuar, nuk është paraparë dhe inkriminuar si vepër penale, por konsiderohet kundërvajtje (sipas KPTK-së nr. 06/ L- 074), andaj bazuar në nenin 2 par. I të KPPRK-së — parimin e ligjshmërisë dhe nenin 3 par. I të KPPRK-së, zbatimi i ligjit më të favorshëm sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 358 par. 1 nën par .1 .3 të KPPRK-së, të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 i KPRK-së 04/1—082 kanë kaluar në kompetencë të Divizionit të Kundërvajtjes si vepër kundërvajtëse.

Në lidhje me pretendimet se gjyqtari ka refuzuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës O.- K.R., nga Suhareka, sipas ligjit të drejtë ankese ka personi përgjegjës dhe paraqitësi i kërkesës, në rastin konkret paraqitësi i kërkesës ka qenë organ i autorizuar dhe jo e dëmtuara, gjithsesi ndaj këtij aktvendimi pala e dëmtuar në rastin konkret përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës O.R., K.R., kanë pasur të drejtë ankese sipas udhëzimit juridik, në Gjykatën e Apelit — Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditëve pas pranimit të vendimit, nëpërmjet Gjykatës Themelore në Prizren.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës, ka cekur se gjyqtari ka pasur interes kundrejt të pandehurës apo të njëjtën e ka familjare dhe për këtë arsye ka vendosur sipas aktgjykimit K.nr.264/2021 -02, por i njëjti nuk ka parashtruar ndonjë provë në lidhje me këto pretendime, andaj autoriteti kompetent ka konsideruar se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk ka pasur ndonjë provë konkrete që mbështet pretendimet e lartcekura.

Për arsyet që u cekura më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligiit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
AD-GJTHPZ.nr.4/2023, me datë 01.03.2023

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren

Shpresa Emira



iparë e drejta e ankesës.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.